



SBASHK

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT



Ë-buletin

Mars, 2022

SBASHK-u në ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe
Urime luftëtarë të dijes e dritës kundër errësirës



Sa herë vjen marsi mësuesit e nxënësit lartësojnë kujtimin për Epopenë e lavdishme të UÇK -së dhe për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit që i ndërruan kahjen historisë dhe u bënë gurë themel të lirisë së Kosovës. Kujtojmë me krenari mësuesin e dëshmorin Shaban Jashari dhe pishtarët e dijes, që nëpër dekada e shekuj mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës. Këtë vit kudo në komunat e Kosovës dhe në institucionet e arsimit lartësimi i kujtimit për pishtarët e dijes dhe ...(faqe 5)

Takime konsultative me kryetarët nivelit komunal e të Universiteteve

Gatishmëri e plotë për përballje me sfidat e kohës



SBASHK ka vazhduar me takimet e shumta ...(faqe 6)

Edhe një shembull i angazhimit të SBASHK-ut për dialog

Letër Presidentes dhe Kryetarit të Parlamentit

Duke vazhduar përpjekjet që të kërkesat e anëtarësisë të zgjidhen ...(faqe 7-8)

Flet për gazetën “Arsimimi sot” kryetari i SBASHK-ut

Jasharaj, po përmbyllim katër vite me plot arritje e suksese



Në përmbyllje të mandatit të dytë kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj ...(faqe 3)

SBASHK ka vazhduar edhe në mars përpjekjet për dialog

Takim me Ministren, takim me përfaqësues të tjerë të MASHTI-t



SBASHK edhe në muajin mars ka vazhduar ...(faqe 5-6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Data e madhe e pishtarëve të dijes



Muaji mars i vitit 2022 e gjeti SBASHK-un para sfidave dhe angazhimeve të shumta. U bën përgatitje me kohë për kremtimin e ditës së madhe të mësuesit në rrethanat e reja të krijuara nga pandemia dhe kjo datë e historisë sonë të lavdishme u shënua në aktivitete të shumta nëpër komuna e Universitete duke u takuar me pishtarët e pensionuar të dijes, duke u ndarë mirënjohje për punën e përkushtimit të tyre në misionin e shenjtë për edukimin e brezave dhe duke kujtuar bashkërisht me ta momente të veçanta nga një jetë e kaluar në arsim. SBASHK edhe në mars vazhdoi me përpjekjet maksimale për të pasur dialog me qeverinë e për të arritur marrëveshje për kërkesat legjitime, por qeveria nuk po

e do dialogun dhe prandaj me kohë u bënë përgatitje që duke respektuar zërin e anëtarësisë të fillohet edhe me veprime sindikale.

Në muajin mars nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, stafi qendror, kryesia dhe kryetarët e nivelit komunal e të universiteteve bashkë me shumë veprimtare e veprimtarë kanë bërë gjithë përgatitjet që Kongresi, si ngjarje e veçantë, të këtë rrjedhë të mbarë duke dëshmuar unitetin e shkëlqyer të SBASHK-ut. Edhe marsi tregoi se anëtarësia është unike dhe nuk ka forcë që ia zbeh besimin në sindikatën e tyre sepse SBASHK- ishte dhe mbetet zëri i tyre i fuqishëm në rrugëtimin drejt realizimit të kërkesave legjitime dhe më mbrojtjen e figurës së mësuesit, të cilën disa të paudhë e të pafytyrë mundohen ta zbehin e të lëndojnë. Por, e kanë të kotë dhe turpi u bie e u mbetet atyre sot e gjithmonë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +381(0)38/ 226 940



Intervista

Flet për gazetën “Arsimimi sot” kryetari i SBASHK-ut

Jasharaj, po përmbyllim katër vite me plot arritje e suksese



Në përmbyllje të mandatit të dytë kryetari i SBASHK-ut Rahman Jasharaj duke folur për gazetën tonë kujton disa nga angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë.

“Falë angazhimit të vazhdueshëm të stafit qendror dhe korrektësisë e transparencës me mediet e nderuara, anëtarësia jonë, por edhe i gjithë opinionimi me kohë janë informuar gjatë gjithë këtyre viteve për kërkesat legjitime, për angazhimin në realizimin e tyre përmes dialogut me institucionet, por edhe për veprimet sindikale, që ndodhën dhe dëshmuar unitet të shkëlqyer të anëtarësisë, unitet ky që ishte dhe mbetet virtyti i SBASHK-ut e që është parë me respekt nga Federatat sindikale në Kosovë dhe nga sindikatat simotra kudo në Ballkan, Evropë e tërë botën. Uniteti, qëndrueshmëria, besimi i ndërsjellë, angazhimi i vazhdueshëm gjithmonë në shërbim të anëtarësisë dhe prezantimi i tyre me dinjitet në takimet ndërkombëtare ka bërë që ta gëzojmë mbështetjen e vazhdueshme të udhëheqësve më të lartë të Internacionales së Arsimit me 32 milionë anëtarë dhe të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës me 12 milionë anëtarë. Kjo përkrahje është dëshmuar vazhdimisht përmes letrave mbështetëse që EI dhe ETUCE ndaj SBASHK-ut dhe përmes shkresave zyrtare drejtuar krerëve të Qeverisë e institucioneve tona me kërkesën konkrete që përmes dialogut të zgjidhën çështjet e ngritura nga ne në emër të anëtarësisë. Por, edhe më shumë se kjo, në momentet kur ishim në përplasje me institucionet dhe përballë sfidave, udhëheqësit më të lartë të EI-së dhe ETUCE vinin në Kosovë për të na dhënë përkrahje dhe në takimet me institucionet për t’u treguar nga afër se mbështesin dhe përkrahin fuqishëm SBASHK-un në përpjekjet për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë. I jemi mirënjohës edhe drejtores së përgjithshme të Unionit të

Sindikatave të Arsimit të Evropës, zonjës së nderuar Suzan Flocken, që u angazhua vazhdimisht në përkrahje të SBASHK duke dërguar shkresa zyrtare Qeverisë, por edhe duke ardhur në Kosovë për ta dëshmuar mbështetjen e ETUCE-s në takimet me udhëheqësit më të lartë të shtetit tonë”, shprehet Jasharaj për të vazhduar se falë angazhimit e përkushtimit maksimal të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri, të tërë stafit qendror, të kryesisë, kryetarëve të nivelit komunal e të universiteteve, të një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të kryetarëve të shoqatave sindikale, por edhe të shumë trajnerëve të nderuar që me sukses i dolën mbanë aktivitetit të trajnimeve të shumta duke respektuar vullnetin e mijëra anëtarëve të SBASHK nga e tërë Kosova. Ai kujton se arritje e madhe e SBASHK-ut ishte Ligji për punëtorët e arsimit shqip të viteve të 90-ta. “Duke i vlerësuar si vite të ndritura dhe duke vlerësuar lart angazhimin sublim të mijëra kolegeve e kolegëve tanë në misionin e shenjtë të edukimit e arsimimit të brezave në vitet kur po mbrohej drita kundër errësirës dhe kur punëtorët e arsimit po qëndronin heroikisht përball sulmeve të pushtuesit ndaj arsimit i kishim dhënë vetit detyrë që me çdo kusht të angazhohemi dhe ta realizojmë Ligjin që do të njihte kontributin e lartë të pishtarëve të dijes.

Kaluam nëpër shumë sfida e përplasje. Morëm pjesë në shumë takime dhe çdo herë e bëmë të qartë se jemi të gatshëm për dialog, por edhe veprime sindikale sepse duam ta realizojmë obligimin që ndjejmë ndaj punëtorëve të arsimit të viteve të 90-ta. Arritëm ta kemi këtë Ligj pas shumë përpjekjesh dhe angazhimesh dhe për të falënderojmë edhe Kryeministrin Haradinaj, që nuk u ndal se vepruari për ta realizuar premtimin e dhënë”, Shprehet Jasharaj për të shtuar se arritje tjetër është edhe Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës.

“Shpreh respekt meritore për Komisionin e SBASHK-ut që ka punuar me zell e përkushtim dhe ka mbrojtur në mënyrë të denjë versionin e përgatitur për Kontratën

Kolektive të Arsimit të Kosovës. Arritje e madhe e SBASHK –ut, në Kontratën e kaluar, por edhe në këtë Kontratën e nënshkruar më 21 janar 2021, është përfshirë i tërë sistemi arsimor, pra edhe Universitetet e Kosovës, që janë pjesë e respektuar e SBASHK–ut. Fakti se SBASHK ka arritur në vazhdimësi të negociojë suksesshëm dhe të nënshkruaj vazhdimisht Kontratat Kolektive është vlerësuar shumë nga Federatat sindikale në Kosovë, por edhe nga sindikatat simotra nga shtete të shumta. Kontratat e nënshkruara ishin dhe mbesin dokument që mundësojnë të realizohen të gjitha të drejtat dhe benifitet, qoftë përmes marrëveshjes e dialogut, qoftë përmes gjykatave”, shprehet Jasharaj, i cili pastaj shton se .Do kujtuar faktin se po të mos ishin nënshkruar këto Kontrata Kolektive të arsimit falë përkushtimit e angazhimit maksimal të komisionit dhe veprimtarëve sindikalë, atë herë as me dialog e as përmes gjykatave nuk do të arrihej dot realizimi i pagave përcjellëse, pagave jubilarë, shujtave e shumë përfitimeve materiale, që janë realizuar nëpër vite për anëtarësinë tonë duke falënderuar edhe përkushtimin e zyrtarit ligjor të SBASHK–ut Blendor Shatri. Vlera e kësaj arritjeje të SBASHK–ut me nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Arsimit sa vjen shtohet nga fakti se përmes saj arritëm të mbrojmë shumë anëtarë tonë kur përballëshin me tendencën që t’u shkeleshin të drejtat e punës”, përmend Jasharaj si arritje të madhe të SBASHK edhe trajnimet e organizuara për mijëra mësimdhënës të Kosovës. Jasharaj në kuadër të kësaj bisede për gazetën tonë ka veçuar edhe se

“Duke dëshmuar përkushtimin për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë SBASHK nuk ka ndalur as njëherë me angazhimet duke bashkëbiseduar me anëtarësinë, duke kërkuar nga institucionet kushte pune për shekullin 21 dhe autonomi akademike për punëtorët arsimorë e pavarësi shumë më të madhe për institucionet arsimore. Një aktivitet i veçantë në këtë përpjekje janë edhe trajnimet . Koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri bashkë me zyrtaren për trajnime Albina Arifi, me stafin qendror, por edhe me shumë nga trajnerët e nderuar kishin përgatitur me kujdes e pedanteri gjithë dokumentacionin e kërkuar duke e

dërguar në Këshillin Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve në kuadër të MASHTI-t dhe pas aprovimit kishin nisur me aktivitetin për organizimin e trajnimeve të aprovuara . Duke parë interesimin e shtuar të anëtarësisë për trajnime të reja stafi qendror bashkë me veprimtarë sindikalë përgatiten edhe trajnime të tjera për të arritur në tetë numri i tyre. Ky aktivitet fillimisht u organizua në ambiente arsimore kudo në Komunitet e Kosovës , por masat e ndikuara nga pandemia kishin bërë që të ndërrohet mënyra e organizimit të këtij aktiviteti, i cili falë përkushtimit të stafit qendror, trajnerëve të nderuar dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal vazhdojë duke pasur rrjedhë të mbarë e duke u shënuar rezultate të jashtëzakonshme e duke tejkaluar dukshëm edhe objektivat e planifikimit e Këshillit Drejtues për përfshirjen në këtë aktivitet të 25 % të anëtarësisë për çdo vit . Po përmendi këtu se vetëm në vitin 2021 më shumë se 6000 kolege e kolegë kanë marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga SBASHK dhe kanë marrë certifikatat si dëshmi se kanë kryer me sukses këtë aktivitet .SBASHK shpreh mirënjohje dhe falënderim për të gjithë trajnerët , që nuk kursyen as kohën e as mundin për realizimin e objektivave të trajnimeve, por në veçanti falënderojmë prof.dr. Alban Zeneli dhe ligjëruesit në Departamentin e Gazetarisë së Universitetin e Prishtinës, profesorin e nderuar nga Bujanovci Agim Hasani,pastaj por. Dr. Hysen Sogojeva , ligjërues në Universitetin e Ferizajt dhe kryetar i Odes së Hotelerisë e Turizmit, prof. Dr. Atdhe Hykolli e trajnerë të tjerë të nderuar. Duke parë mobilizimin dhe gatishmërinë e stafit qendror dhe të trajnerëve jemi të sigurt se ky aktivitet tepër i rëndësishëm e domethënës do të vazhdojë se realizuari me këto tetë trajnime , por edhe me trajnime të reja bazuar në kërkesat dhe vullnetin e anëtarësisë”, thotë Jasharaj

Ai lavdëron stafin edhe për angazhimin maksimal në organizimin me sukses të aktivitetit tradicional të pushimeve në bregdetin shqiptar për qindra punëtorë arsimor nga e tërë Kosova dhe e Manifestimit madhështor kushtuar ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe.

Gjatë muajit

SBASHK-u në ditën e madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe Urime luftëtarë të dijes e dritës kundër errësirës

Sa herë vjen marsi mësuesit e nxënësit lartësojnë kujtimin për Epopenë e lavdishme të UÇK -së dhe për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit që i ndërruan kahjen historisë dhe u bënë gurë themel të lirisë së Kosovës. Kujtojmë me krenari mësuesin e dëshmorin Shaban Jashari dhe pishtarët e dijes, që nëpër dekada e shekuj mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës.



Sa herë vjen marsi mësuesit e nxënësit lartësojnë kujtimin për Epopenë e lavdishme të UÇK -së dhe për komandantin legjendar Adem Jashari dhe gjithë dëshmorët e kombit që i ndërruan kahjen historisë dhe u bënë gurë themel të lirisë së Kosovës. Kujtojmë me krenari mësuesin e dëshmorin Shaban Jashari dhe pishtarët e dijes, që nëpër dekada e shekuj mbrojtën rrezet e dritës kundër errësirës.

Këtë vit kudo në komunat e Kosovës dhe në institucionet e arsimit lartësimi i kujtimit për pishtarët

e dijes dhe ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve nga SBASHK për të pensionuarit u shoqërua edhe me momente të dhembjes duke përmendur në shenjë nderimi emrat e kolegeve e kolegëve tanë, që Covidi duke u bërë mik i ngushtë me vdekjen, na i rrëmbeu nga mesi ynë duke ua ndaluar angazhimin në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave, por i përjetshëm do të jetë kujtimi për ta.



Punëtorë të nderuar të arsimit ju bashkë me nxënësit do të vazhdoni betejën për dije e njohuri të reja, ndërsa SBASHK do të vazhdojë me përkushtimin në prezantimin dhe realizimin e kërkesave tuaja. Urojmë që kjo datë e madhe e mësuesit dhe shkollës shqipe dhe kontributi i madh i pishtarëve të dijes nëpër vite e dekada në shërbim të kombit e atdheut të jetë shtytje shtesë për institucionet që të bëjnë angazhim konkretet në plotësimin e kërkesave tuaja, që i kemi bërë publike. SBASHK edhe në këtë ditë feste kujton institucionet se vazhdojmë angazhimet që kërkesat t'i realizojmë me dialog, por po përgatitemi edhe për veprime sindikale.

Bashkë në SBASHK në rrugëtimin tonë drejt arritjeve të reja. Gëzuar dita e mësuesit dhe e shkollës shqipe

SBASHK ka vazhduar edhe në mars përpjekjet për dialog

Takim me Ministren, takim me përfaqësues të tjerë të MASHTI-t

SBASHK edhe në muajin mars ka vazhduar angazhimet që me dialog të zgjidhën kërkesat e anëtarësisë duke dërguar kërkesa për takime të bartësit e funksioneve të larta në institucionet e Kosovës. Në kuadër të kësaj ka zhvilluar një takim me zv/ministrin Pupovci, drejtorin e departamentit ligjor Isni Kryeziu dhe me këshilltarë të ministres Nagavci. Temë kryesore e këtij takimi ishte shqetësimet e arsyeshme të anëtarësisë së SBASHK-ut lidhur me

Ligjin e pagave dhe kërkesa për qeverinë që të mbështesë të gjithë të punësuarit në arsim për shkak të ngritjes së madhe të çmimeve të artikujve elementarë me një shtesë prej 100 euro në pagat e tyre aktuale. Zv/ministri Pupovci është deklaruar se kërkesat e SBASHK do i përcjell Ministres e po ashtu ka thënë se SBASHK të dërgojë versionin e argumentuar për pjesën e ka të bëjë me arsimin të Ligji i pagave, të cilin MASHTI do ta analizojë me kujdes.



REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Kryetari Jasharaj dhe nënkryetarja Shala kanë pasur një takim edhe me Ministren Nagavci, të cilës i kanë kujtuar se janë shtuar pakënaqësitë në tërë sistemin arsimor për arsye të heshtjes së vazhdueshme të Qeverisë ndaj kërkesave të arsyeshme të tyre dhe kanë kërkuar që Ministria të angazhohet në Qeveri që të merret vendim për realizimin e kërkesës së SBASHK për shtesën prej 100 euro në paga për të gjithë të punësuarit në arsim që nga çerdhet e deri në universitet dhe për institucione të kulturës. Duke parë se Ministria Nagavci nuk po jep ndonjë sinjal optimizmi, përfaqësuesit e SBASHK-ut i kujtuan se

nëse Qeveria vazhdon me qasje të tillë ndaj kërkesave të SBASHK, atëherë duke respektuar zërin e anëtarësisë do të fillohet me veprime sindikale duke mos përjashtuar edhe grevën e përgjithshme.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe nënkryetarja Vjollca Shala kanë kujtuar edhe një herë bashkëbiseduesit se kohës së dialogut po i vije fundi dhe se SBASHK duke respektuar vullnetin e anëtarësisë do të nis me veprime sindikale dhe se për çdo gjë që ndodh pastaj fajtoje vetme do të jetë Qeveria e Kosovës.

Komisioni përgatitor dhe stafi në nivel të lartë të detyrës **Duan që Kongresi të ketë rrjedhë të mbarë**

Në takimin e përbashkët të Këshillit Drejtues dhe kryetarëve të nivelit komunal sindikal e të universiteteve janë emëruar komisionet gjegjëse për përgatitjen e Kongresit të 8-të. Komisioni për përgatitjen e Kongresit i udhëhequr nga nënkryetarja Vjollca Shala ka bërë planifikimin paraprak të aktiviteteve dhe duke pasur përkrahjen konkrete të koordinatorit për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe veprimtarëve vullnetar sindikal kanë arritur të realizojnë gjithë detyrat që garantojnë se kjo ngjarje e madhe dhe e veçantë do të ketë fillim dhe përmbyllje të mbarë.



Po ashtu edhe Komisioni kandidues ka mbajtur takime të shumta duke analizuar kandidimet e ardhura për kryetar dhe ato për Komisionin mbikëqyrës e atë

statutor përgatiti raportin që do ia prezantojë delegatëve të Kongresit.

Po ashtu janë dërguar ftesat edhe për mysafirët e nderuar dhe në bazë të përgjigjeve të tyre shihet respekti i lartë për SBASHK-un edhe nga miqtë ndërkombëtarë ngase ka konfirmuar pjesëmarrjen në Kongres drejtorja e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Suzan Flocken, mikja e madhe e SBASHK-ut Trudi Kerperien, që është nënkryetare e ETUCE, anëtare e bordit të EI dhe sekretare për marrëdhënie me jashtë e sindikatës së arsimit të Holandës me të cilën SBASHK ka bashkëpunim të shkëlqyer nëpër vite e dekada. Do të jenë në Kongres edhe kryetarë të shumë prej sindikatave simotra nga shtete të ndryshme.




Takime konsultative me kryetarët nivelit komunal e të Universiteteve **Gatishmëri e plotë për përballje me sfidat e kohës**

SBASHK ka vazhduar me takimet e shumta konsultative me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve duke bashkëbiseduar vazhdimisht për situatën aktuale në arsim dhe për sfidat me të cilat po përballemi vazhdimisht në angazhimet për realizimin e kërkesave të anëtarësisë. Temë e debatit në këto takime ishin përpjekjet që me dialog të zgjidhën kërkesat legjitime të anëtarësisë, por edhe përgatitjet që janë duke u bërë që në mungesë të dialogut të fillohet me veprime sindikale për të cilat janë deklaruar me kohë anëtarësia përmes nënshkrimeve të tyre. Po ashtu rëndësi meritore në këto takime i është dhënë përgatitjeve që janë bërë e duhen bërë për mbajtjen e ngjarjes së veçantë për SBASHK-un, pra Kongresi i 8-të.

Në këto takime u vlerësuar se SBASHK ka bërë shumë angazhime dhe ka qenë e mbetet shembull i shkëlqyer i përkushtimit për dialog me institucionet, por janë Qeveria dhe ministritë ato, që po ikin dialogut dhe prandaj ndaj kësaj qasjeje të gabuar të tyre, pa

dëshirën tonë jemi të detyruar të përgatitemi e të veprojmë sipas zërit të anëtarësisë.

Lidhur me Kongresin në këto takime janë dhënë raporte të përgatitjeve dhe janë analizuar e miratuar shumë ide që kontribuojnë në rrjedhën e mbarë të punimeve të Kongresit. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve kanë përgëzuar komisionit e përgatitjes, komisionet tjera dhe stafin qendror për angazhimin e tyre maksimal në shërbim të realizimit me kohë të gjithë detyrave konkrete, që janë të shumta, por falë zellit e angazhimit të përbashkët janë kryer me përpikëri.



Edhe një shembull i angazhimit të SBASHK-ut për dialog

Letër Presidentes dhe Kryetarit të Parlamentit

Duke vazhduar përpjekjet që të kërkesat e anëtarësisë të zgjidhen me dialog e duke u nisur nga realiteti se Qeveria ka qasje të gabuar ndaj dialogut, SBASHK u ka dërguar letrë Presidentes së Kosovës Vjosa Osmani dhe kryetarit të Parlamentit Glauk Konjufca me kërkesën që ta shfrytëzojnë pozitivisht autoritetin e tyre dhe të ndikojnë që Qeveria Kurti të ketë takime përmbajtësore me SBASHK-un dhe të angazhohet të bëjë zgjedhje ndaj kërkesave legjitime të sindikatës sonë.

Në letrat dërguar presidentes Osmani dhe kryeparlamentarit Gonjufca thuhet :

“Me mirësi Ju lusim që të angazhoheni për të ndërmjetësuar me qëllim që të niset me dialogun e mirëfilltë mes Qeverisë, gjegjësisht Ministrave gjegjës dhe SBASHK-ut, ngase edhe përkundër shumë shkrësive e apeleve tona publike, Qeveria nuk është

përgjigjur duke mohuar çdo mundësi që çështjet e ngritura sipas kërkesave legjitime të të punësuarve në tërë sektorin e arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete dhe në sektorin e kulturës të debatohen dhe të gjendet zgjidhje e pranueshme.

E nderuara Presidente, i nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës si dëshmi e kësaj qasjeje të Qeverisë ndaj sindikatave është edhe formimi i grupit punues për përgatitjen e draft ligjit të pagave, në të cilin ka përfaqësues nga institucionet e palët tjera, por nuk është as edhe një përfaqësues i SBASHK-ut e as i ndonjë sindikate tjetër. Kemi adresuar edhe kërkesa të tjera modeste të ardhura nga anëtarësia jonë, por ato le që nuk janë plotësuar, por as që është shprehur vullnet e gatishmëri e Qeverisë për të debatuar me ne për këto kërkesa. E gjithë kjo ka ndikuar që të shtohen tensionet mes anëtarësisë sonë dhe shumica e tyre me deklarime të nënshkruara kërkojnë që Kongresi që

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

mbahet më 2 prill të merr vendim për veprime sindikale nëse mbetet gjendja kjo që është tani. Me qëllimin më të mirë që të mos ndodh greva e përgjithshme Ju drejtohem që të angazhoheni si ndërmjetësues që në këto ditët e mbetura deri në Kongres të ketë dialog konkret të Qeverisë me SBASHK-un për të arritur marrëveshje të pranueshme

për çështjet e ngritura në mënyrë që të mos ketë arsye për veprime sindikale.

E dimë se keni angazhime të shumta, por presim përkushtimin tuaj dhe jemi të gatshëm në çdo kohë të takohemi me Ju me qëllim që t'ju ofrojmë informacione të shumta për të gjitha çështjet e ngritura".



SBASHK / UESCK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
The Union of Education, Science and Culture of Kosovo

Pristinë, 25.03.2022

Sindikata e Bashkuar e
Arsimit, Shkencës dhe
Kulturës e Kosovës

The Union of Education,
Science and Culture of
Kosovo

Kryetar/President
Rrahman JASHARAJ
rahman.jasharaj@sbashk-rks.org

Nënkryetar/Vice-President
Vjollca SHALA
vjollca.shala@sbashk-rks.org

Sekretare e Përgjithshme/
Secretary General
Jehona ORUÇI
jehona.oruci@sbashk-rks.org

Përgjegjës administrativ/
Administrative responsible
Ymer YMERI
ymer.ymeri@sbashk-rks.org

Adresa/Address:
Rr. Agim Ramadani pn,
Qendra e Studimeve -
Drejtoria
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

sbashk2004@yahoo.com
info@sbashk-rks.org
Tel +383(0) 38 225 940

www.sbashk-rks.org

Presidencës së Republikës së Kosovës

Presidentes, Shkëlqesisë së saj, Vjosa Osmani,

E nderuara Presidente e Republikës së Kosovës Ju përshëndesim nga SBASHK. Me mirësi Ju lusim që të angazhoheni për të ndërmjetësuar me qëllim që të nisët me dialogun e mirëfilltë mes Qeverisë, gjegjësisht Ministrave gjegjëj dhe SBASHK-un, ngase edhe përkundër shumë shkresave e apeleve tona publike, Qeveria nuk është përgjigjur duke mohuar çdo mundësi që çështjet e ngritura sipas kërkesave legjitime të të punësuarve në tërë sektorin e arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete dhe në sektorin e kulturës të debatohen dhe të gjenden zgjidhje e pranueshme.

E nderuara Presidente si dëshmi e kësaj qasje të Qeverisë ndaj sindikatave është edhe formimi i grupit punues për përgatitjen e draft ligjit të pagave, në të cilin ka përfaqësues nga institucionet e palët tjera, por nuk është as edhe një përfaqësues i SBASHK-un e as i ndonjë sindikate tjetër. Kemi adresuar edhe kërkesa të tjera modeste të ardhura nga anëtarësia jonë, por ato le që nuk janë plotësuar, por as që është shprehur vullneti e gatishmëri e Qeverisë për të debatuar me ne për këto kërkesa. E gjithë kjo ka ndikuar që të shtohen tensionet mes anëtarësive sonë dhe shumica e tyre me deklarime të nënshkruara kërkojnë që Kongresi që mbahet më 2 prill të merr vendim për veprime sindikale nëse mbetet gjendja kjo që është tani.

E nderuara Presidente me qëllimin më të mirë që të mos ndodh greva e përgjithshme Ju drejtohem që të angazhoheni si ndërmjetësues që në këto ditët e mbetura deri në Kongres të ketë dialog konkret të Qeverisë me SBASHK-un për të arritur marrëveshje të pranueshme për çështjet e ngritura në mënyrë që të mos ketë arsye për veprime sindikale.

E nderuara Presidente e dimë se keni angazhime të shumta, por presim përkushtimin tuaj dhe jemi të gatshëm në çdo kohë të takohemi me Ju me qëllim që t'ju ofrojmë informacione të shumta për të gjitha çështjet e ngritura.

Me respekt,

Rrahman Jasharaj,
Kryetar

R. Jasharaj



SBASHK / UESCK
Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës
The Union of Education, Science and Culture of Kosovo

Pristinë, 25.03.2022

Sindikata e Bashkuar e
Arsimit, Shkencës dhe
Kulturës e Kosovës

The Union of Education,
Science and Culture of
Kosovo

Kryetar/President
Rrahman JASHARAJ
rahman.jasharaj@sbashk-rks.org

Nënkryetar/Vice-President
Vjollca SHALA
vjollca.shala@sbashk-rks.org

Sekretare e Përgjithshme/
Secretary General
Jehona ORUÇI
jehona.oruci@sbashk-rks.org

Përgjegjës administrativ/
Administrative responsible
Ymer YMERI
ymer.ymeri@sbashk-rks.org

Adresa/Address:
Rr. Agim Ramadani pn,
Qendra e Studimeve -
Drejtoria
10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës

sbashk2004@yahoo.com
info@sbashk-rks.org
Tel +383(0) 38 225 940

www.sbashk-rks.org

Parlamentit të Republikës së Kosovës

Kryetari, z. Glauk Konjufca

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës Ju përshëndesim nga SBASHK. Me mirësi Ju lusim që të angazhoheni për të ndërmjetësuar me qëllim që të nisët me dialogun e mirëfilltë mes Qeverisë, gjegjësisht Ministrave gjegjëj dhe SBASHK-un, ngase edhe përkundër shumë shkresave e apeleve tona publike, Qeveria nuk është përgjigjur duke mohuar çdo mundësi që çështjet e ngritura sipas kërkesave legjitime të të punësuarve në tërë sektorin e arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete dhe në sektorin e kulturës të debatohen dhe të gjenden zgjidhje e pranueshme.

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës si dëshmi e kësaj qasje të Qeverisë ndaj sindikatave është edhe formimi i grupit punues për përgatitjen e draft ligjit të pagave, në të cilin ka përfaqësues nga institucionet e palët tjera, por nuk është as edhe një përfaqësues i SBASHK-un e as i ndonjë sindikate tjetër. Kemi adresuar edhe kërkesa të tjera modeste të ardhura nga anëtarësia jonë, por ato le që nuk janë plotësuar, por as që është shprehur vullneti e gatishmëri i Qeverisë për të debatuar me ne për këto kërkesa. E gjithë kjo ka ndikuar që të shtohen tensionet mes anëtarësive sonë dhe shumica e tyre me deklarime të nënshkruara kërkojnë që Kongresi që mbahet më 2 prill të merr vendim për veprime sindikale nëse mbetet gjendja kjo që është tani.

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës me qëllimin më të mirë që të mos ndodh greva e përgjithshme Ju drejtohem që të angazhoheni si ndërmjetësues që në këto ditët e mbetura deri në Kongres të ketë dialog konkret të Qeverisë me SBASHK-un për të arritur marrëveshje të pranueshme për çështjet e ngritura në mënyrë që të mos ketë arsye për veprime sindikale.

I nderuari Kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës e dimë se keni angazhime të shumta, por presim përkushtimin tuaj dhe jemi të gatshëm në çdo kohë të takohemi me Ju me qëllim që t'ju ofrojmë informacione të shumta për të gjitha çështjet e ngritura.

Me respekt,
Rrahman Jasharaj,
Kryetar

R. Jasharaj

Një aktivitet solidariteti i SBASHK-ut

E duam lirinë edhe për të tjerët, i urrejmë pushtuesit



Udhëheqësit sindikal të EI-së dhe ETUCE-s u ishin drejtuar sindikatave anëtare nga vendet demokratike të Evropës e tërë botës me apel që në shenjë solidariteti me nxënësit dhe mësimdhënësit e Ukrainës e për ta gjykuar publikisht agresionin rus të zhvillojnë aktivitete që bartin mesazhe mbështetjeje e solidariteti me nxënësit dhe mësimdhënësit e Ukrainës.

SBASHK duke parë fotografi e xhirime të këtij aktiviteti kudo në shkollat e Kosovës ka vlerësuar lart këtë aktivitet, i cili dërgoi mesazh domethënës të



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

mbështetjes e solidaritetit për nxënësit dhe mësimdhënësit e Ukrainës e duke gjykuar në të njëjtën kohë agresionin rus.

SBASHK i ka dërguar informatë Internacionales së Arsimit (EI) dhe Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE). Ne te ju lexues të nderuar po përcjellim përmbajtjen e informatës bashkë me Deklaratën e përbashkët të EI-ETUCE për Ukrainën.

"I nderuari Sekretar i përgjithshëm i EI-së, z. Edvards, e nderuara Drejtore e përgjithshme e ETUCE, znj. Flocken Ju përshëndesim dhe urojmë të jeni mirë.

Ju falënderojmë për këshillat lidhur me solidaritetin dhe mbështetjen për kolegët tanë ukrainas. Ju informojmë se SBASHK iu bashkua kolegeve e kolegëve sindikalistë nga Evropa dhe e tërë bota duke apeluar te gjithë anëtarësia jonë për një aktivitet solidariteti për nxënësit dhe kolegët tanë ukrainas e duke gjykuar e dënuar agresionin e Rusisë.

Ky aktivitet u zhvillua në orët e para në të dy ndërrimet e mësimi në shumicën e shkollave të Republikës së Kosovës dhe nxënësit dhe mësimdhënësit nga i gjithë vendi ynë me fjalë e shprehje nga zemra shprehen solidaritetin duke bashkë ndjerë dhembjen për gjendjen atje dhe për viktimat e pafajshme e duke gjykuar agresionin rus me lutjen e përbashkët që atje të ndalet lufta dhe të kthehet paqja, të dëgjohet zilha e shkollës dhe kënga e buzëqeshja e fëmijëve të Ukrainës. Ky aktivitet ka arritur efektin e pritur dhe është përcjellë edhe nga mediet e po ashtu janë publikuar pamje të shumta nga ky aktivitet edhe në rrjetet sociale. Po ashtu kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka dhënë deklaratë për shumë medie të Kosovës për këtë aktivitet solidariteti dhe është kyçur në një debat për solidaritetin për Ukrainën edhe në një televizion të Shqipërisë.

I nderuari Sekretar i përgjithshëm i EI-së, z. Edvards, nderuara Drejtore e përgjithshme e ETUCE, znj. Suzan Flocken ne bashkë me këtë informatë të shkurtër po ju dërgojmë edhe foto e pamje të xhiruara nga ky aktivitet yni.

Po ashtu Ju informojmë se në faqen tonë zyrtare bashkë me një përshkrim të aktivitetit tonë ilustruar me shumë foto po botojmë edhe Deklaratën e

përbashkët EI-ETUCE për Ukrainën. E po ashtu do të botojmë edhe shkrime e foto nga aktivitetet e sindikatave simotra në mbështetje të kolegëve tanë në Ukrainë.", thuhet në informatën e SBASHK-ut.

Kjo është Deklarata e përbashkët të EI- ETUCE për Ukrainën.

Edukatorët në mbarë botën qëndrojnë me popullin e Ukrainës dhe dënojnë aktin e luftës të Rusisë





Duke injoruar lutjet globale për paqe dhe diplomaci, Rusia ka nisur një pushtim të pajustificueshëm në shkallë të plotë të Ukrainës. Internacionalja e Arsimit solidarizohet me mësuesit, studentët dhe popullin e Ukrainës dhe i bën thirrje komunitetit ndërkombëtar të ndalojë gjakderdhjen dhe të bëjë çmos për të shmangur një krizë katastrofave humanitare në Evropë.

Sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës është i papranueshëm. Edukatorët në mbarë botën qëndrojnë me kolegët, studentët dhe komunitetet tona në Ukrainë dhe denoncojnë pushtimin. Konflikti ka kushtuar tashmë 14,000 jetë që nga viti 2014, duke plagosur mijëra dhe duke zhvendosur 1.5 milion njerëz. Dhuna duhet të ndalet. Komuniteti ndërkombëtar duhet të qëndrojë i bashkuar përballë këtij agresioni dhe të mbështesë të drejtën e Ukrainës për të zgjedhur të ardhmen e saj", tha David Eduards, Sekretari i Përgjithshëm Ndërkombëtar i Arsimit.

Susan Flocken, Drejtore e ETUCE, Rajoni Evropian i Arsimit Ndërkombëtar tha se Mësuesit, akademikët dhe sindikatat e tyre në Evropë janë të tronditur nga ndërhyrja ushtarake e Federatës Ruse në shtetin sovran të Ukrainës. ETUCE dënon sulmin e Rusisë ndaj Ukrainës dhe shpreh mbështetjen e saj të fortë dhe solidaritetin e thellë me kolegët, mësuesit, akademikët dhe studentët dhe të gjithë njerëzit e Ukrainës. Jetët e miliona njerëzve janë në rrezik. Lufta dhe pushtimi nuk duhet të ndodhin kurrë në shoqëritë bashkëkohore ku njerëzit përdorin fjalë dhe jo armë për të arritur një zgjidhje. Pushtimi duhet të pushojë.

Ne jemi angazhuar me organizatat anëtare në Rusi dhe Ukrainë për të theksuar rëndësinë e dialogut dhe të ruajtjes së vlerave të arsimit dhe paqes. Ne afirmojmë angazhimin tonë të palëkundur ndaj organizatave tona anëtare në Ukrainë - Sindikata e Punëtorëve të Arsimit dhe Shkencës të Ukrainës (TUESWU) dhe Sindikata e Lirë e Arsimit dhe Shkencës të Ukrainës (VPONU).



Në deklaratën e tyre, TUESWU, e cila përfaqëson 1.4 milionë punonjës të arsimit në Ukrainë, theksoi se ky skenar agresiv do të ketë pasoja katastrofike humanitare, por gjithashtu do të dëmtojë ndjeshëm ekonominë e vendit. Miliona vende pune mund të shkatërrohen, dhe shkatërrimi i institucioneve arsimore, shërbimeve sociale dhe ekonomisë do të çonte në varfëri dhe skamje. Mirëqenia sociale dhe respektimi i të drejtave të punëtorëve nuk do të ishin më në agjendë.



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

Pushtimi i Rusisë në territorin sovran të Ukrainës është një shkelje flagrante e ligjit ndërkombëtar që do të rezultojë në humbje tragjike të jetës njerëzore dhe kërcënon jo vetëm sigurinë e Ukrainës, por të gjithë rajonit. Pasojat e gjera të këtij akti lufte nuk mund të nënvlerësohen.



Populli i Ukrainës ka të drejtë për një të ardhme pa dhunë dhe luftë. Ata kanë të drejtën sovranë për të vendosur në mënyrë demokratike të ardhmen e tyre si komb. Bota duhet të qëndrojë me ta dhe të dyfishojë përpjekjet për të siguruar paqen në vend dhe në kontinent.

